



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 796 prot.

Ballsh, më 22.02.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. 10, datë 22.02.2024

“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 12, DATË 24.02.2020, TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALLAKASTËR””

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, lligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S A:

1. Në tekstin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Mallakastër, të miratuar me VKB-në nr.12, datë 24.02.2020, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 32 ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 32

Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm

Këshilli i Bashkisë ka **9 (nëntë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

1. Komisioni i ekonomisë, 5 anëtare/ë
2. Komisioni i juridik, 5 anëtare/ë
3. Komisioni i bujqësisë, 5 anëtare/ë
4. Komisioni i menaxhimit të pasurive të paluajtëshme, 5 anëtare/ë
5. Komisioni i arsimit, 5 anëtare/ë
6. Komisioni i emrgjencave, 5 anëtare/ë
7. Komisioni i barazisë gjinore, 5 anëtarë/e
8. Komisioni i këshillit vendor për sigurinë publike, 4 anëtarë/e
- 9. Komisioni i integritit evropian, 5 anëtare/ë.**

2. Komisioni i integritit evropian të përbëhet nga pesë (5) këshilltarë, tre nga shumica dhe dy nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë “Pro” shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë

gjinore. Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

Komisionit i integritit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritit Evropian, organizon në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Nexhmi Sulaj

